



Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve


PLANI SEKTORIAL I TURIZMIT

VITI 2025



OBJEKTIVAT E PLANIT


- Rritja e qarkullimit të deklaruar gjatë sezonit turistik 2025, në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2024, si tregues i efektivitetit të masave të monitorimit dhe formalizimit
- Rritja e numrit të punonjësve të deklaruar nga subjektet në sektorin e turizmit, përmes evidentimit të saktë të fuqisë punëtore dhe deklarimit real të marrëdhënieve të punës.
- Rritja e fondit të pagave të deklaruara për popullatën e targetuar aktive, duke siguruar raportim të saktë dhe bazuar në pagat reale sipas profesioneve dhe pozicioneve të punës.
- Reduktimi i numrit të tatimpaguesve që deklarojnë punonjës me pagë minimale, përmes analizës së kategorive të punësimit dhe krahasimit me të dhënat reale të tregut të punës.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i përmbushjes vullnetare të detyrimeve fiskale nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e turizmit.
- Rritje në numrin e tatimpaguesve deklarues me përgjegjësi TVSH në turizëm, me normë tatimore 6% ,ku objektivi është 20% rritje të numrit të tatimpaguesve.





OBJEKTIVAT E PLANIT

- Rritje e TVSH-së e paguar në sektorin e turizmit , me norme tatimore 6% ku objektivi është 20% rritje e të ardhurave nga sektori i turizmit.
- Rritje në numrin e tatimpaguesve deklarues TVSH në turizëm (Akomodim, Bar-restorante) që kanë normë standarte tvsh-je ku objektivi është 10% rritje i numrit të tatimpaguesve.
- Monitorimi i pagesave me qëllim parandalimin e krijimit të borxhit të ri tatimor, përfshirë detyrimet për TVSH dhe tatimet e tjera të lidhura me aktivitetin ekonomik.
- Formalizimi i sektorit të turizmit, përmes reduktimit të numrit të subjekteve të paregjistruara apo të regjistruara dhe janë pasive që ushtrojnë aktivitet ekonomik në mënyrë të parregullt.
- Regjistrimi në përgjegjësinë e TVSH-së të tatimpaguesve që ushtrojnë veprimtari turistike, bazuar në të dhëna reale si qarkullimi, numri i dhomave, dhe numri i punonjësve.
- Rritja e numrit të tatimpaguesve të rregjistruar në përgjegjësinë e Tatimit në Burim, rritja e numrit të deklarimit dhe pagesave për Tatimin në Burim për subjektet në sektorin e turizmit.





PLAN VEPRIMI

- Monitorimi dhe raportimi i subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit (çadra, shezllone, etj.) pa kontratë të lidhur me autoritetet përkatëse, me qëllim evidentimin dhe formalizimin e këtyre veprimtarive.
- Monitorimi dhe vlerësimi i nivelit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese, në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr.160, datë 12.03.2025, me qëllim evidentimin e kapaciteteve reale të përdorura, krahasimin me të dhënat e deklaruara dhe përmirësimin e përmbushjes tatimore nga subjektet e sektorit të akomodimit.
- Sensibilizimi i tatimpaguesve për zbatimin e rregullave të faturimit në strukturat akomoduese si :
 - Përdorimi i emërimit "Dhomë" në përshkrimin e artikullit në faturat për shërbimin e akomodimit.
 - Specifikimi i saktë i kohëzgjatjes së qëndrimit (numri i ditëve/netëve) në çdo faturë, duke shmangur përshkrime të përgjithshme.
 - Ndarja e qartë e çmimit të shërbimit të akomodimit nga shërbimet e tjera (restorant, çadra, shezlongë, pishinë), përveç rasteve të paketave të integruara (shërbime të kombinuara).
 - Lëshimi i faturës për çdo shezlong/çadër nga subjektet që operojnë në stacione plazhi.
 - Zbatimi i saktë i shkallës së reduktuar të TVSH-së (6%) vetëm për furnizimin e shërbimit të akomodimit, sipas përcaktimeve ligjore.
- Përdorimi i pajisjeve fiskale dhe deklarimit të saktë të qarkullimit, në funksion të transparencës fiskale dhe uljes së informalitetit në aktivitetet ekonomike të lidhura me turizmin.





POPULLATA E TURIZMIT

Duke konsideruar sektorin e turizmit (strukturat akomoduese, hotelet, bar-restorantet, agjencitë turistike dhënia me qera të makinave dhe mjeteve të transportit ujor) si një nga sektorët me risk të lartë potencial në aspektin e përmbushjes tatimore, komunikimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës tatimpaguese që operon në këtë sektor mbetet prioritet thelbësor për zbatimin efektiv të planit.

Popullata e synuar përfshirë në këtë plan do të rishikohet dhe përditësohet periodikisht gjatë shtrirjes kohore të zbatimit të tij, për të reflektuar ndryshimet strukturore të subjekteve që ushtrojnë aktivitet. Kjo popullatë do të paraqitet në plan sipas rëndësisë së aktivitetit ekonomik, duke vlerësuar rolin dhe ndikimin e çdo subjekti në sektorin përkatës.

Për zbatimin efektiv të këtij plani operacional, përveç strukturave të Administratës Tatimore (Drejtoritë Rajonale dhe Qendrore), përfshihen edhe institucione dhe aktorë të tjerë bashkëpunues, të cilët kontribuojnë në ndërtimin e një panorame të plotë dhe të përditësuar të tatimpaguesve pjesë e sektorit të turizmit.

Në këtë popullatë janë përfshirë:

- TP me kode REV 2, (I) dhe (N) nga popullata
- Tatimpaguesit që rezultojnë të regjistruar pranë Ministrisë së Turizmit për struktura akomoduese, hotele, agroturizëm;
- Tatimpagues Aktive/Pasivë të cilët kanë pasur aktivitet gjatë Qershor- Shtator 2024;
- Tatimpagues Aktive/Pasivë hapur në vitin 2025 ;
- Tatimpagues (marrë të dhëna nga burime të tjera).





PLANI I KOMUNIKIMIT ME TATIMPAGUESIT

Në funksion të zbatimit të **Planit të Turizmit** dhe për të garantuar ndërgjegjësimin, informimin dhe përfshirjen aktive të tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitetet në sektorin e turizmit, Administrata Tatimore do të ndërmerret një sërë veprimesh komunikimi dhe këshillimi.



Njoftimi i tatimpaguesve do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të personalizuar, duke përfshirë:

- Informimin e përgjithshëm mbi qëllimin, objektivat dhe masat që do të ndërmerren në kuadër të Planit të Turizmit;
- Këshillimin individual për përmbushjen korrekte të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mjetet dhe kanalet e komunikimit me tatimpaguesit do të përfshijnë:

- Publikimet zyrtare në faqen zyrtare të Administratës Tatimore;
- Dërgimin e njoftimeve (POP-UP) nëpërmjet platformës e-Filing, në llogaritë individuale të tatimpaguesve;
 - Informimi i tatimpaguesve nëpërmjet dërgimit të 2 mesazheve POP-UP : mbi ndryshimet ligjore të parashikuara në VKM nr. 160, datë 12.03.2025, për përcaktimin e periudhës dhe nivelit minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese.
 - Ndërgjegjësimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari akomoduese për detyrimin e deklarimit të kapacitetit dhe nivelit të shfrytëzueshmërisë për vitin 2025, brenda afatit 30-ditor nga data e botimit të VKM-së në Fletoren Zyrtare.
- Shfrytëzimin e rrjeteve sociale institucionale (Facebook, Instagram) për informim të gjerë dhe ndërveprim me publikun;
- Dërgimin e njoftimeve përmes postës elektronike (email);
- Aktivizimin e Qendrave të Thirrjeve dhe Asistencës për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes në kohë reale;
- Komunikime me postë në formën e njoftimeve të personalizuara për tatimpaguesit që përfshihen në popullatën objekt të planit.





DREJTORIA E MENAXHIMIT TË RISKUT



- Monitorimi i nivelit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 12.03.2025, përmes analizës së të dhënave të vetëdeklarimit dhe të dhënave fiskale.
- Përditësimi periodik i bazës së të dhënave të popullatës së sektorit të turizmit, me fokus në struktura akomoduese dhe hotele, në bashkëpunim me burimet e palëve të treta (Ministria e Turizmit, AKPT, njësitë vendore etj.).
- Monitorimi mbi baza javore i qarkullimit të tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitetet në sektorin e turizmit, duke përdorur të dhëna nga faturat e fiskalizuara dhe deklaratat tatimore.
- Mbikëqyrja e deklarimit të detyrimeve tatimore në përputhje me afatet ligjore, përfshirë TVSH-në, tatimin mbi fitimin dhe tatimin në burim.
- Monitorimi i përmbushjes së detyrimeve tatimore përmes pagesave të kryera dhe identifikimi i rasteve të vonesave në shlyerjen e këtyre detyrimeve.
- Analiza e statusit të tatimpaguesve në popullatë (aktivë/pasivë/të regjistruar rishtazi) për të identifikuar ndryshimet strukturore dhe sjelljet fiskale në sektor.
- Analiza e tatimpaguesve me sjellje devijante, të tilla si:
 - Dorëzimi i deklaratave me vlera zero, pavarësisht ushtrimit të aktivitetit;
 - Rënie e theksuar e xhiros në krahasim me periudha të mëparshme;
 - Vonesë e përsëritur në përmbushjen e detyrimeve tatimore.
- Krahasimi i të dhënave fiskale përmes:
 - Xhiros në faturat e fiskalizuara dhe deklaratave të TVSH-së.
 - Qarkullimit mes muajve të njëpasnjëshëm dhe/ose mes viteve të njëpasnjëshëm.
 - Xhiros së deklaruar dhe numrit të punonjësve.
 - Numrit të punonjësve dhe përgjegjësisë tatimore për TVSH.



DREJTORIA E MENAXHIMIT TË RISKUT



VAT

- Krahasimi i qarkullimit nga deklaratat e TVSH-së, muaj të njëpasnjëshëm ose të dy viteve të njëpasnjëshme
- Krahasimi i xhiros së deklaruar me numrin e punonjësve
- Krahasimi i numrit të punonjësve dhe përgjegjesisë tatimore TVSH
- Analiza për struktura akomoduese mbi një kapacitet të caktuar, për të verifikuar përputhjen me regjistrimin në TVSH.
- Monitorimi dhe analiza javore e faturave të fiskalizuara, për artikuj të veçantë si "akomodim", "çadër", "shezllon", etj., në krahasim me kapacitetet e deklaruar në popullatë.
- Identifikimi i subjekteve që aplikojnë normën e reduktuar 6% të TVSH-së, pa qenë të certifikuar si struktura akomoduese sipas përcaktimeve ligjore.
- Analiza e subjekteve mbi një numër të caktuar punonjësish, ku përqindja më e madhe e tyre janë të deklaruar ne kufijnjtë e pagës minimale.
- Përcaktimi I pagave referuese për profesion në sektorin turizëm dhe identifikimi I tatimpaguesve me risk
- Propozimi i masave trajtuese për tatimpaguesit me sjellje të dyshimtë ose të ndryshuar, bazuar në nivelin e riskut dhe rënien e xhiros në raport me periudha monitoruese.
- Vlerësimi dinamik i popullatës së sektorit të turizmit, duke u bazuar në trendet e xhiros dhe sjelljes fiskale javore dhe gjatë fundjavave, për të evidentuar periudhat e fluksit të lartë.
- Analizimi dhe monitorimi i qarkullimit në CPCMC sipas fashave orare, me fokus te oraret me fluks të shtuar klientësh.
- Monitorimi dhe analizimi I subjekteve në platformat Booking, AIRBNB për përcaktimin e çmimeve që ofrojnë strukturat akomoduese duke bërë krahasimin me sistemin e fiskalizimit .



DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE VERIFIKIMIT NE TERREN

Monitorimi i platformave Booking, AIRBNB për pëcaktimin e çmimeve që ofrojnë strukturat akomoduese.
Verifikimi në terren i subjekteve të identifikuara me risk (Qershor , Korrik , Gusht, Shtator).
Monitorimi dhe raportimi I rasteve te ndryshme te denoncuar

Drejtimit kryesore me karakter të përgjithshëm:

(I) Vlerësimin për zbatimin e VKM nr.160 datë 12.03.2025 për tatimpaguesit.

(II) Verifikimet me karakter të përgjithshëm

Regjistrimi i subjekteve tregtare në QKB dhe në organin tatimor sipas pershkrimit te aktivitetit
Identifikimi , komunikimi dhe monitorimi I tatimpaguesve me status ‘Pasiv’
Fiskalizimi i subjekteve dhe lëshimin e faturave e fiskalizuara
Verifikimi i deklarimit të punonjësve në organin tatimor
Verifikimi për dokumentimin me faturë tatimore të mallrave në subjekt
Verifikimi për dokumentimin e pronësisë së ambjentit të ushtrimit të aktivitetit
Afishimin e çmimeve për produktet/shërbimet e ofruara, në vende të dukshme për publikun

(III) Verifikimi i punonjësve të deklaruar

Në sektorin e turizimit punësimi është kryesisht sezonal dhe me një qarkullim të lartë vjetor. Lidhur me kontrollin e situatës për deklarimin e punonjësve u kryen:

Verifikimi të punonjësve të padeklaruar.

Verifikimi i nivelit të pagave për të konstatuar nëse deklarimet jane kryer për pagat reale.
Verifikimin e strukturave apartament, vile, etj, që operojnë nëpërmjet Booking, Airbnb, etj

**Bashkëpunim midis Dr. së Hetimit Tatimor dhe DVKT-së
Përdorimi I metodave speciale**



DREJTORIA E KONTROLLIT TATIVOR



Menaxhimi dhe koordinimi i punës me Drejtoritë e Kontrollit në Drejtoritë Rajonale në mënyrë që të zbatohen dhe arrihen objektivat kryesorë të vendosur.

- Mbikqyrjen e cilësisë së raportimeve nga ana e kontrollit nga zyra në DRT
- Asistencën teknike në ndërlidhjen funksionale të aktorëve kryesorë në zbatimin e planit.
- Vlerësimin për zbatimin e VKM nr.160 datë 12.03.2025 për tatimpaguesit .



MATJA E REZULTATEVE



- Ecuria e qarkullimit nga Deklarata e TVSH-së mbi baza mujore krahasuar me muajin si dhe vitin parardhës.
 - Ecuria e qarkullimit monitorohet mbi baza mujore, përmes krahasimit me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe me muajin paraardhës të vitit aktual, me qëllim identifikimin e tendencave dhe devijimeve në deklaratimet e TVSH-së.
- Krahasimi i xhiros & numrit të faturave nga fiskalizimi mbi baza mujore krahasuar me të njëjtën periudhë me muajin si dhe me vitin parardhës.
 - Krahasimi i listëpagesave realizohet në mënyrë mujore, duke u ballafaquar si me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës, ashtu edhe me muajin paraardhës të vitit aktual, për të evidentuar ndryshimet në numrin dhe nivelin e punonjësve të deklaruar.
 - Numri i tatimpaguesve të regjistruar për TVSH
 - Numri i tatimpaguesve të regjistruar për TB ,numri i deklaruesve dhe vlera e deklairimit mbi baza mujore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit parardhës per TB
 - Pagesat në kohë të detyrimeve tatimore
 - Deklarimi në kohë i deklaratave tatimore